



Në mbështetje të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe nenit 65-dh paragrafi (1) i Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16 dhe 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19 dhe 122/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR METODOLOGJINË E
IDENTIFIKIMIT TË BANKAVE ME RËNDËSI SISTEMORE
("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 88/21)

1. Në vendimin për metodologjinë e identifikimit të bankave me rëndësi sistemore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 26/17) në të gjithë tekstin fjalët: "Republika e Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët: "Republika e Maqedonisë së Veriut", përveç pikës 14) të këtij Vendimi.

2. Në pikën 4), paragrafi (2) fjalët: "Banka maqedonase për mbështetje zhvillimore" zëvendësohen me fjalët: "Banka Zhvillimore e Maqedonisë së Veriut".

3. Pika 10) ndryshon si më poshtë:

"10. Në bazë të metodologjisë nga pika 1) e këtij vendimi dhe udhëzimit nga pika 12) e këtij vendimi, Banka Popullore i identifikon bankat me rëndësi sistemore.

Për çdo bankë me rëndësi sistematike nga paragrafi (1) i kësaj pike, guvernatori i Bankës Popullore miraton vendim me të cilin përcaktohet shuma e shkallës së shtresës mbrojtëse të kapitalit që duhet të mbajë banka dhe ia dorëzon bankës jo më vonë se data 30 prill e çdo viti.

Banka nga paragrafi (1) i kësaj pike është e detyruar të respektojë normën e shtresës mbrojtëse të kapitalit të përcaktuar në vendimin nga paragrafi (2) i kësaj pike, jo më vonë se data 31 marsi të vitit vijues."

4. Pika 11) ndryshon si më poshtë:

"11. Në pajtim me ligjin, Banka Popullore publikon listën e bankave të identifikuar si banka me rëndësi sistemore në faqen e saj të internetit."

5. Në pikën 12), paragrafi (1), pika dhe presja në nënparagrafin (5) zëvendësohen me pikë ndërsa paragrafi (6) fshihet.

6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë të publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

V nr. 02-15/V-2/2021
19 prill 2022
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska